

KONTRATE SHITBLERJE AKSIONESH

Sot, me date 05.04.2021, lidhet kjo Kontrate Shitblerje Aksionesh (këtu e më poshtë referuar si "**Kontrata**") midis palëve si me poshtë vijon:

I. SHITESI:

"**UNION DISTRIBUCION SERVIS ALBANIA**" shpk, shoqeri shqiptare me përgjegjesi te kufizuar, me NUIS: K11506007W, dhe adrese Rruga e "Kavajes", ish stabilimenti "Mihal Duri", Hyrja 1, Kati 2, Tirane, perfaqesuar nga Administratori i saj, Z.Illir Karaguni.

(me poshte referuar si "**Shitesi**");

dhe

II. BLERESI:

"**UNION GRUP**" sha, shoqeri shqiptare aksionare, me NUIS: K61527801R, dhe adrese Rruga Ismail Qemali, nr.32, kati 3, 1019, Njesia Bashkiake nr.5, Tirane, perfaqesuar nepermjet Vendimit të Asamblesë së Aksionarëve të kësaj Shoqërie me Nr. — Prot., datë 05.04.2021, nga aksionari i saj, Z.Varuzhan Piranjani.

(me poshte referuar si "**Bleresi**");

(më poshtë referuar veç e veç si "**pala**" dhe së bashku si "**palët**")

DUKE QENE SE:

- a) Shitesi eshte aksioner ne shoqerine "DIGIT-ALB" sha, me NUIS: K41719004D dhe adrese: Tirane, Kashar, Rruga "Pavarësia", nr. 39.
- b) "DIGIT-ALB" sha ka një kapital themeltar prej 230.076.000 (dyqind e tridhjetë milionë e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) Leke, te ndare ne 230.076 (dyqind e tridhjetë mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) aksione, secili aksion me vlerë nominale prej 1.000 (një mijë) lekë.
- c) Shitesi është aksioner me pjesëmarrje prej 6.8% (gjashtë pikë tetë përqind) në "DIGIT-ALB" sha, duke zotëruar 15.645,5 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e pesë pikë pesë) aksione me të drejtë vote në "DIGIT-ALB" sha.
- d) Blerësi është gjithashtu aksioner me pjesëmarrje prej 6.8% (gjashtë pikë tetë përqind) në "DIGIT-ALB" sha, duke zotëruar 15.645,5 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e pesë pikë pesë) aksione me të drejtë vote në "DIGIT-ALB" sha.
- e) Shitesi deshiron t'i shesë blerësit të gjitha akcionet që ai zotëron në "DIGIT-ALB" sha (me tej "**Aksionet ne Shitje**"), dhe Bleresi deshiron te bleje Aksionet ne Shitje, kundrejt vlerës dhe sipas kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë.
- f) Shitesi ka marre te gjitha miratimet e nevojshme per permbushjen e kesaj Kontrate dhe transferimin e Aksioneve nga Shitesi tek Bleresi, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, Statutin e "DIGIT-ALB" sha dhe kete Kontrate, dhe nuk ka asnje pengese nga ndonje e drejte parablerjeje per lidhjen e kesaj Kontrate.

Palet, mbi bazen e veprimeve te meposhtme, njohin dhe deklarojne si vijon:

NENI 1 OBJEKTI

1. Objekti i kesaj kontrate eshte shitja e Aksioneve ne Shitje te zoteruara nga Shitesi dhe blerja e tyre nga Bleresi siç detajohet më poshtë:
 - 1.1 Shitesi i shet dhe i transferon Blerësit dhe ky i fundit pranon te blejë nga Shitesi, të gjitha aksionet që Shitësi zotëron në "DIGIT-ALB" sha.
 - 1.2 Më konkretisht, Shitesi i shet dhe i transferon Blerësit dhe ky i fundit pranon te blejë nga Shitësi, 15.645,5 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e pesë pikë pesë) aksionet me të drejtë vote, që Shitësi zotëron në "DIGIT-ALB" sh.a.
 - 1.3 Si rezultat i shitjes së lartpërmendur, pjesëmarrja aksionare e Blerësit Union Grup sha në shoqërinë DIGIT-ALB sha:
Është: 6.8% (gjashtë pikë tetë për qind) pjesëmarrje, zotërues i 15.645,5 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e pesë pikë pesë) aksione me të drejtë vote;
Bëhet: 13.6% (trembëdhjetë pikë gjashtë për qind) pjesëmarrje, zotërues i 31.291 (tridhjetë e një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një) aksione me të drejtë vote.

NENI 2 ÇMIMI I SHITJES DHE MENYRA E PAGESES

- 2.1 Përkundrejt kalimit te pronësisë se Aksioneve ne Shitje sipas përcaktimeve me sipër, Blerësi do të paguajë tek Shitësi, një çmim total shitje të barabartë me 42,905,876 (dyzet e dy milionë e nëntëqind e pesë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë (**çmimi i shitjes**).
- 2.2 Blerësi do ta likuiojë çmimin e shitjes brenda 1 (një) viti kalendarik, nga data e lidhjes së kesaj Kontrate.
- 2.3 Çmimi i shitjes do të paguhet nga blerësi duke kredituar llogarinë bankare të Shitësit si me poshte vijon:

Llogaria bankare e Shitesit:

IBAN: AL66214112090 111100104120115

NENI 3 TRANSFERIMI I AKSIONEVE

- 3.1. Me ane te kesaj Kontrate, ne datën e lidhjes së saj, Shitesi i transferon Blerësit pronësinë e plotë mbi Aksionet ne Shitje sipas Nenit 1 me lart, me te gjitha te drejtat dhe përfitimet që lidhen me to, të çliruara nga çdo barrë.
- 3.2 Palet kane rene dakord qe kalimi i pronesise se Aksioneve nga Shitesi tek Bleresi do te ndodhe ne momentin e nenshkrimit te kesaj Kontrate nga palet.
- 3.3 Blerësi duke nënshkruar këtë Kontratë dhe duke marre ne zotërim Aksionet ne Shitje, është dakord dhe pranon te gjithë te drejtat, kufizimet, deklaratat, rregullat e procedurat e

përcaktuara ne Statutin e Shoqërisë “DIGIT-ALB” sha për aksionet që ai merr në pronësi.

NENI 4 Ndryshimet

4.1 Cdo ndryshim i kesaj Kontrate eshte i ligjshem vetem nese bëhet me shkrim dhe nenshkruhet nga secila palë dhe referohet specifikisht ne kete Kontrate.

NENI 5 Ndarja

5.1 Nese ne ndonje rast ndonje nga kushtet e kesaj Kontrate eshte ose behet i paligjshem ose i padetyrueshem, atehere nje kusht i tille do te konsiderohet i ndare nga kjo Kontrate dhe nese eshte e mundur te zevendesohet nga nje kusht i ligjshem i cili permbush, sa me shume te jete e mundur, qellimin e Paleve te kesaj Kontrate dhe aty ku eshte e lejueshme nuk do te demtojë ose keqësojë vlefshmerine ose detyrimin e ndonje kushti tjetër te kesaj Kontrate.

NENI 6 TE TJERA

6.1 Palet pranojne qe cdo deklarate, dorezim apo garanci e Paleve, sic parashikohet ne kete Kontrate, eshte e vërtete dhe e sakte.

6.2 Kjo marreveshje rregullohet dhe interpretohet ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise.

6.3 Palet bien dakort qe cdo mosmarreveshje qe lind ne lidhje me vlefshmerine, interpretimin apo zbatimin e kesaj kontrate te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.



6.4 Kjo Kontrate nenshkruhet nga Palet ne 5 (pesë) kopje me vlerë autentike, ne gjuhen shqipe.

Për Shitesin

“UNION DISTRIBUCION SERVIS ALBANIA” shpk

Administratori

Z. Ilir Karaguni



Për Blerësin

“UNION GRUP” sha

Z. Varuzhan Piranjani

